



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0392

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Panelist Individual duke vendosur sipas ankesës së OE Marisa SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugës Radoniqit” me numër të prokurimit 632-25-2207-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 08.07.2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Marisa SH.P.K. me nr. 2025/0392, e datës 22.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugës Radoniqit”, me numër të prokurimit 632-25-2207-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.
2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugës Radoniqit”, me numër të prokurimit 632-25-2207-5-2-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.03.2025 KOMUNA E GJAKOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugës Radoniqit”, me numër të prokurimit 632-25-2207-5-2-1.

Me 02.05.2025 KOMUNA E GJAKOVËS., ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin ku ka shpërblyer me kontratë GOE BK Construction sh.p.k & Q Shala.

Me 26.04.2025, OE Marisa SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 12.05.2025.

Me 22.05.2025, OE Marisa SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0392, duke e atakuar Njoftimin për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Marisa SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Vendimi i marrë nga AK Komuna e Gjakovës është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe me të gjitha rregullat e saj.

Kërkojmë nga OSHP trajtimin e kësaj lënde në bazë të LPP-së dhe të gjitha rregullave dhe udhëzuesve në fuqi, pasi që AK Komuna e Gjakovës nuk ndalet së shkeluri Ligjin e Prokurimit Publik dhe nuk e trajton asnjë kërkesë për rishqyrtim të cilën e paraqesim ne.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme), në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit për shpalljen fitues të operatorit ekonomik BK Construction sh.p.k., për arsye se ky i fundit nuk i plotëson disa nga kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Konkretisht, shkeljet e konstatuara janë si më poshtë:

Pretendimi 1 - Mospërmbushja e kriterit për certifikim nga MPMS

Në Dosjen e Tenderit, në pikën D, është kërkuar qartë që:

“Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka një punëtor të certifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë”

Operatori ekonomik i shpallur fitues ka ofruar një certifikatë të lëshuar nga një subjekt privat dhe jo nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), siç kërkohet shprehimisht.

Kjo mospërputhje përbën shkelje të kriterëve thelbësorë teknike dhe e bën ofertën teknikisht të papërgjegjshme.

Kjo është Certifikata të cilën ka paraqitur GOE BK Construction Sh.p.k. është e lëshuar nga një Kompani Private.

Pretendimi 2 - Mospërmbushja e kërkesës për referenca dhe kontrata

Në dokumentet e tenderit është kërkuar që OE-ja të dëshmojë me referenca dhe kontrata me më shumë se një kontratë të natyrës së ngjashme. OE-ja fituese ka ofruar vetëm një kontratë, duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar në mënyrë të qartë në Dosjen e Tenderit për përvojë relevante dhe të mjaftueshme.

Pretendimi 3 - Mungesa e listës së punëtorëve të angazhuar

Gjithashtu, është kërkuar lista e numrit të punëtorëve të angazhuar, me këto të dhëna:

Emri dhe Mbiemri i punëtorit

Profesioni dhe pozicioni në kompani

GOE nuk ka dorëzuar këtë listë dhe as kontratat e punëtorëve, të cilat përbëjnë pjesë përbërëse të vlerësimit të kapaciteteve njerëzore.

Pretendimet për OE Asfalt Sh.p.k

Pretendimi 4. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kompania “Asfalt sh.p.k.”, është evidentuar se një sërë kërkesash të përcaktuara në Dosjen e Tenderit nuk janë përmbushur, konkretisht në lidhje me stafin profesional dhe kapacitetet teknike.

Stafi profesional dhe dëshmia për angazhim

Lista e personelit e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dosjen e Tenderit, pasi mungojnë të dhënat dhe dëshmitë për personelin kyç.

Në listë nuk është përfshirë gjeodeti dhe as personi i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, të cilët përbëjnë kërkesa të domosdoshme për projektin në fjalë.

Inxhinieri i hidroteknikës nuk figuron fare në listën e stafit, ndonëse roli i tij është esencial për realizimin e punimeve sipas specifikave teknike.

Kapacitetet teknike - makineritë

Lista e makinerive është plotësuar në mënyrë joformale (me dorë) dhe nuk përmban përshkrime teknike të detajuara për secilën njësi të pajisjeve.

Përshkrimi teknik i makinerive mungon ose është i paplotë, duke pamundësuar vlerësimin e saktë të kapaciteteve teknike të ofruara.

Duke u bazuar në sa më sipër, vlerësojmë se dokumentacioni i dorëzuar nuk përmbush kriteret minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Bazuar në dokumentet e paraqitura, vlerësojmë se shpallja e GOE-së në fjalë si fitues është bërë në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e parashtruara në dosjen e tenderit, si dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme.

Kërkojmë nga OSHP-ja që të anulohet vendimi për shpalljen e GOE-së fitues dhe lënda të kthehet në rivlerësim në përputhje me kriteret e parashikuara në dokumentet e tenderit dhe të shpallemi fitues ne Marisa sh.p.k., pasi i plotësojmë të gjitha kushtet dhe kriteret për kontratë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me Certifikatën për siguri dhe shëndet në punë të prezantuar nga Operatorii i rekomanduar për kontratë, është i pabazuar, sepse i njëjti ka prezantuar certifikatë të lëshuar nga NM/X sh.p.k., e cila është e licencuar nga MPMS-ë, dhe në këtë pikë plotëson kërkesën e FDT-së dhe Njoftimit për kontratë;

Pretendimi juaj lidhur me kontratat e natyrës së ngjashme, nuk qëndron sepse Autoriteti Kontraktues nuk ka caktuar se sa kontrata të prezantohen, mjafton që kontrata / kontratat e prezantuara nga operatori ekonomik të plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktues në FDT-ë;

Pretendimi juaj lidhur me listën e punëtorëve të angazhuar, nuk qëndron sepse Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar listën e stafit teknik, listën e stafit profesional dhe listën e ATK-së, me çka plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues në FDT-ë;

Sa i përket pretendimeve të juaja për Operatorin Ekonomik “Asfalt” sh.p.k., Autoriteti Kontraktues nuk do të lëshohet në shqyrtimin e tyre, sepse të njëjtin Autoriteti Kontraktues e ka shpallur si të pasuksesshëm.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 02.06.2025, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pabazuar,
- Mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar përderisa AK është pajtuar me raportin e ekspertit. Krahës kësaj konstatohet se palët janë të informuara reciprokisht lidhur me shkresat kësaj lënde (nga platforma e prokurimit elektronik) në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e

prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Marisa SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0392 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjakovës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 149,068.00 €.Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6, 7, 56, 60 dhe 69 të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues është shpallur si ofertë e pasuksesshme sipas Letrës standarde B46 për tenderuesin e pasuksesshëm. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigjeje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë BK Construction sh.p.k nuk i plotëson disa nga kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Tutje OE ankues potencon se i njëjti nuk ka plotësuar kriterin për certifikim nga MPMS ndërsa në dosjen e tenderit tek piken D është kërkuar: “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka d.) një punëtor i çertifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë”

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një certifikata të lëshuar nga një subjekt privat dhe jo nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), kjo mospërputhje përbën shkelje të kriterëve dhe e bene ofertën teknikisht te papërgjegjshme.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT është kërkuar: d.) një punëtor i certifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë.

Në lidhje me këtë kërkesë grupit i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë BK Construction sh.p.k, me ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: “Stafi Teknik dhe Profesional.rar”, “Stafi Teknik dhe Profesional\Certifikatat e Punëtorëve për Siguri dhe Shëndet në Punë” , ku rezulton se pesë (5) nga punëtorët e stafit janë të certifikuar me certifikata për sigurinë dhe shëndetin në punë. Sa i përket pretendimit ankimor se certifikata është e lëshuar nga një subjekt privat dhe jo nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ekspertja shqyrtuese sqaron se certifikatat janë të lëshuara nga kompania NMA SHPK në përputhje me autorizimin e licencës nga MPMS ME NR.03/2018, për me tepër ne ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), është e publikuar faqja me kompanitë e licencuara për ofrimin e shërbimeve në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ku ndër to është edhe kompania e cila i ka lëshuar këto certifikata. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Provë:<https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/kompanite-e-licencuara-per-siguri-dhe-shendet-ne-pune/>

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë

BK Construction sh.p.k nuk ka plotësuar kërkesën për referenca dhe kontrata, në dosjen e tenderit është kërkuar që operatorët ekonomik të dëshmojnë me referenca dhe kontrata me më shumë se një kontratë të natyrës së ngjashme. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar vetëm një

kontratë duke mos përmbushur kërkesën e përcaktuar të dosjes së tenderit për pervojën relevante dhe të mjaftueshme.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 220.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista e kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punimeve, në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë. Në lidhje me këtë kërkesë të dosjes së tenderit, ekspertja shqyrtuese sqaron se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë BK Construction sh.p.k, kanë dorëzuar me tender dokumentin me titull: a) Kontratat e realizuara\Lista e kontratave të realizuara.pdf, me gjithsej nëntë (9) kontrata dhe dokumentit tjetër Kontratat e Realizuara, Referencat e Procesverbalet.pdf, me gjithsej gjashtë (6) kontrata të realizuara.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se grupi i operatoreve ekonomik te rekomanduar për kontrate përbehet nga dy operator ekonomik OE “BK-Construction SH.P.K” lider i grupit dhe “Q-Shala “Sh.p.k, të cilët kanë bashkëngjitur listën e kontratave, që së bashku plotësojnë kërkesën e AK-së kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit , Sa i përket çështjes së “kontratave të ngjashme”, ekspertja shqyrtuese vlerëson se është kompetencë ekskluzive e AK-së se cilat nga kontratat i konsideron si të ngjashme. Për më shumë, referoju opinionit të KRPP-së me nr.11 i dt. 09.06.2023. Andaj pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Provë: Lista e kontratave a) Kontratat e realizuara\Lista e kontratave të realizuara.pdf, dhe Kontratat e Realizuara, Referencat e Procesverbalet.pdf,

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë

BK Construction sh.p.k nuk ka plotësuar kërkesën për listën e punëtorëve të angazhuar, ku është kërkuar lista e numrit te punëtorëve te angazhuar me këto te dhëna, emri dhe mbiemri i punëtorit, profesioni dhe pozicioni në kompani. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar këtë listë dhe as kontratat e punëtorëve të cilat përbejnë vlerësim te kapaciteteve njerëzore.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm , si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit

a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv me minimum 5vite përvojë pune pas diplomimit (menaxher i projektit).

b.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknikë, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit (udhëheqës i punishtes).

c.) një inxhinier i gjeodezisë apo master i gjeodezisë, i licencuar (Agjensioni Kadastral i Kosovës).

d.) një punëtor i çertifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, udhëheqës i punishtës duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për udhëheqës i punishtes, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

Në lidhje me këtë kërkesë, ekspertja shqyrtuese sqaron se grupit i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë BK Construction sh.p.k, kanë dorëzuar me tender dokumentin me titull: “Stafi Teknik dhe Profesional.rar”

Stafi Teknik dhe Profesional\Certifikatat e Punëtorëve për Siguri dhe Shëndet në Punë

Stafi Teknik dhe Profesional\ a) Enver Gashi-Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë-Konstruktiv.pdf, Stafi Teknik dhe Profesional\ b) Avdi Kusari - Inxhinier i Ndërtimtarisë-Hidroteknikë.pdf, Stafi Teknik dhe Profesional\ c) Ramiz Selmani-Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë.pdf, Stafi Teknik dhe Profesional\Lista e punëtorëve.pdf, Stafi Teknik dhe Profesional\Lista e stafit profesional.pdf, Stafi Teknik dhe Profesional\Lista e stafit teknik.pdf

Stafi Teknik dhe Profesional\Vendim për Menaxherin e Projektit.pdf, Stafi Teknik dhe Profesional\Vendim për Udhëheqësin e Punishtes.pdf

Po ashtu është bashkangjitur edhe lista e këtyre punëtorëve të deklaruar nga punëdhënësi OE “BK-Construction SH.P.K, në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK).

Përderisa punëtorët e lartcekur sipas listës së stafit profesional dhe teknik të bashkangjitur me ofertë janë të deklaruar nga punëdhënësi (në këtë rast nga OE i rekomanduar për kontratë), vërtetohet se të njëjtit janë në marrëdhënie pune. Andaj, duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si me lartë, ekspertja shqyrtuese vlerëson se grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën e Kapaciteti teknik dhe profesional të përcaktuar në dosjen e tenderit. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Provë: Lista e Stafit Teknik dhe Profesional\Lista e stafit profesional.pdf, dhe Stafi Teknik dhe Profesional\Lista e stafit teknik.pdf si dhe Lista e punëtorëve të deklaruar në ATK

Pretendimi ankimor 4: OE ankues në ankesë ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë tender OE “Asfalti” shpk. Konkretisht i ka ngritur dy pretendime ankimore, ku pretendimi i parë është se OE “Asfalti” nuk ka plotësuar kërkesën e

kapacitetit teknik, konkretisht në lidhje me stafin profesional ,1.stafi profesional dhe dëshmia për angazhim. Lisat e personelit e dorëzuara nuk përputhet me kërkesat e specifikuara në DT pasi mungojnë të dhënat dhe dëshmitë për personelin kyç. Në listë nuk është përfshirë gjeodeti dhe as personi i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë të cilët përbejnë kërkesat e domosdoshme për projektin në fjalë. Inxhinieri i hidroteknikes nuk figuron fare në listën e stafit ndonëse roli i tij është esencial për realizimin e punimeve sipas specifikave teknike.

Pretendimi ankimor 5: Kurse pretendimi i dytë ankimor kundrejt ofertës së OE “Asfalti” është se ky OE nuk ka plotësuar kërkesën e kapacitetit teknik-makineritë. Lista e makinerive është plotësuar në mënyrë joformale (me dorë) dhe nuk përmbajnë përshkrimin teknik të detajuar për secilin njësi të pajisjeve, përshkrimi teknik i makinerive i mungon ose është i paplotë duke pamundësuar vlerësimin e sakte të kapaciteteve të ofruara. Tutje OE ankues potencon se shpallja e GOE të rekomanduar për kontratë është bërë në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit si dhe në kundërshtime me parimet e transparencës trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4/5: Ekspertja shqyrtuese bazuar në platformën e-prokurimit, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimi kanë marr pjesë gjithsej shtatë (7) operatorë ekonomik, ku gjashtë (6) operatorët ekonomik pjesëmarrës sipas letrës standarde nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, janë të pasuksesshëm për arsye se ofertat e tyre nuk kanë qenë me çmimin më të ulët, sipas kriterit të dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se edhe nëse lënda do të kthehet në rivlerësim dhe operatorët pjesëmarrës do të konsideroheshin të papërgjegjshëm ose të përgjegjshëm nuk do të këtë ndryshim në rezultatin final sepse oferta e grupit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

Provë: B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 30.04.2025

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht në harmoni me nenin 1, 6, 7 dhe 59 të LPP-së.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka

gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KOMUNA E GJAKOVËS, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i rrugës Radoniqit”, me numër të prokurimit 632-25-2207-5-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Marisa SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: